Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0598

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahimi-Paneliste Indeividuale duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) FWRDZ L.L.C., kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit të POLICIA E KOSOVËS në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit FURNIZIM ME SPALETA RITENDER me numër të prokurimit 214/30400-26-4777-1-2-1, me 22/09/2026, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE FWRDZ L.L.C. me nr. 2026/0598 , e datës 13/08/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit FURNIZIM ME SPALETA RITENDER me numër të prokurimit 214/30400-26-4777-1-2-1.

2. Anulohet, B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të POLICIA E KOSOVËS, ndërkaq aktiviteti i prokurimit FURNIZIM ME SPALETA RITENDER me numër të prokurimit 214/30400-26-4777-1-2-1,. Ndërkaq aktiviteti kthehet në Rivlerësim.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik FWRDZ L.L.C.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 17.06.2026. POLICIA E KOSOVËS, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit: “FURNIZIM ME SPALETA RITENDER” me nr. të prokurimit: "214/30400-26-4777-1-2-1",

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 119,459.00 €.

Me 29.07.20206 POLICIA E KOSOVËS, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi anulimin (B58), ku është anuluar aktiviteti.

Me 03.08.2026, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 06.08.2026. AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 13.08.2026, OE "FWRDZ L.L.C. ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2026/0429, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, kunder anulimit të aktivitetit.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "FWRDZ L.L.C. janë parashtruar si në vijim:

Pika 1 e AK-se - mostra e re eshte produkt i modifikuar AK thote se mostra e procedures se kaluar kishte deshtuar ne elementet vizuale, perkatesisht te ylli dhe vija e grades Kadet, dhe se mostra e procedures se re paraqet produkt te modifikuar. Nga kjo AK perfundon se raporti laboratorik i nje mostre qe ka deshtuar nuk mund te certifikoje mostren e re te modifikuar. Kundershtimi: PROFI LAB ka sqaruar zyrtarisht se, pervec rasteve kur kjo perfshihet posacerisht ne fushen e testimit, ekzaminimet laboratorike nuk vleresojne dhe nuk certifikojne pamjen vizuale, elementet dekorative, modelet e qendisjes apo karakteristika te tjera estetike. PROFI LAB ka sqaruar me tej se, kur produktet prodhohen me te njejtin material, perberje identike, specifikime teknike identike dhe te njejtin proces prodhimi, ndryshimet vetem vizuale nuk perbejne deshmi laboratorike se karakteristikat teknike te testuara kane ndryshuar. Ne rastin konkret, korrigjimet e bera ne mostren e procedures aktuale kane qene ne elementet vizuale te konstatuara ne proceduren e meparshme, ndersa materiali i perdorur eshte i njejti material me te njejten perberje dhe karakteristika teknike te materialit te testuar ne laborator. Prandaj, korrigjimi i yllit ose i vijes se grades nuk mund te barazohet automatikisht me ndryshim te materialit ose te parametrave laboratorike pa nje baze teknike qe e provon kete. 2. Pika 2 e AK-se - raportet nuk ishin aprovuara ne heshtje AK thote se fakti qe raportet laboratorike nuk jane kontestuar ne proceduren e meparshme nuk nenkupton aprovim ne heshtje, pasi vleresimi ishte ndalur pas konstatimit te mosperputhjeve te mostres fizike. Kundershtimi: Ankuesi nuk pretendon se raportet laboratorike jane aprovuara ne heshtje. Rendesia e procedures se meparshme qendron ne faktin se OE nuk eshte eliminuar dhe as nuk eshte njoftuar per ndonje problem lidhur me metoden ISO 3801 apo me fushen e akreditimit te laboratorit. Arsyet e eliminimit ne proceduren e meparshme kane qene te tjera, sic deshmohet nga vendimi i meparshem i AK-se, i cili eshte bashkengjitur si prove ne kete ankese. Sikur ceshtja lidhur me metoden ISO 3801 apo fushen e

akreditimit te ishte evidentuar dhe komunikuar nga AK ne proceduren e meparshme, OE do te kishte pasur mundesi ti drejtohej menjehere laboratorit per sqarimin dhe korrigjimin e gabimit administrativ. Ne ate rast, ne proceduren aktuale OE do te kishte qene ne gjendje ta paraqiste raportin me shenimin e sakte te metodes EN ISO 12127:2014. OE nuk ka pasur mundesi te jete ne dijeni per nje gabim administrativ te bere nga laboratori dhe te pakomunikuar me pare. Menjehere pasi kjo ceshtje eshte ngritur ne proceduren aktuale, OE i eshte drejtuar laboratorit per sqarim. PROFI LAB ka konfirmuar zyrtarisht se shenimi i metodes ISO 3801 Part III ne raportin T102557-2 ka qene rezultat i nje gabimi administrativ dhe se gjate testimit eshte perdorur metoda EN ISO 12127:2014. Ky sqarim nuk paraqet ndryshim te ofertes dhe as zevendesim te nje dokumenti qe ka munguar ne oferte, por sqarim nga vete leshuesi lidhur me permbajtjen teknike te nje raporti laboratorik ekzistues. Pavaresisht kesaj, argumenti juridik kryesor mbetet se Dosja e Tenderit kerkon ateste te kryera nga laborator i akredituar per artikujt nr. 4 dhe 8 sipas specifikimeve teknike, por nuk percakton date skadence te atesteve, ritestim te detyrueshem apo kusht qe atestet te jene leshuar posacerisht per kete procedure te ritenderit. Per rrjedhoje, fakti se raportet nuk jane kontestuar ne proceduren e meparshme nuk perdoret nga ankuesi si pretendim per aprovim ne heshtje, por si rrethane faktike qe deshmon se OE nuk ka qene me pare i njoftuar per ceshtjen konkrete te metodes ISO 3801/akreditimit dhe nuk ka pasur mundesi ta adresoje ate para procedures aktuale. Prandaj, edhe nese pranohet plotesisht arsyetimi i AK-se se nuk ka pasur aprovim ne heshtje, kjo nuk zgjidh pyetjen kryesore: cila dispozite e Dosjes se Tenderit e ben te detyrueshem raportin e ri ose ritestimin? 3. Pika 3 e AK-se - Neni 59 dhe "siguria teknike" AK pranon shprehimisht ne vendim se Dosja e Tenderit nuk specifikon date skadence per raportet laboratorike, por argumenton se qellimi i raporteve eshte te garantojne perputhshmerine e produktit aktual dhe se perdorimi i atestit T102557-2 nga procedura e meparshme cenon sigurine teknike. Kundershtimi: Pranimi i AK-se se DT nuk specifikon date skadence eshte i rendesishem, por nuk duhet interpretuar si pranim nga AK se DT nuk kerkon raport te ri. Kjo e fundit eshte pretendimi i ankuesit dhe mbeshtetet ne tekstin konkret te "Kerkeses 2 / Deshmise 2", ku kerkohen ateste te kryera nga laborator i akredituar sipas specifikimeve teknike, pa u percaktuar nje kerkese e tille shtese. Ne specifikimet teknike te Aneksit 1 eshte kerkuar qe materialet themelore, ngjyrat dhe materialet me te cilat punohen/qendisen spaletat te deshmohen me atestet laboratorike perkatese. Ky formulim tregon se AK ka kerkuar ateste per materialet themelore/baze dhe jo ateste per produktin final apo per secilen moster fizike. Per rrjedhoje, eliminimi i ofertes sone mbi kete baze eshte ne kundershtim me kriteret e percaktuara paraprakisht nga vete Autoriteti Kontraktues. Neni 59 i LPP-se rregullon ekzaminimin, vleresimin dhe krahasimin e tendereve. Paragrafi 2 lejon qe AK te kerkoje me shkrim sqarim per nje aspekt te tenderit, pa ndryshuar aspektet materiale. Ky mekanizem eshte vecanerisht relevant kur AK ka dyshim per kuptimin ose lidhjen e nje dokumenti ekzistues. 4. Konstatimi i AK-se se raporti duhet te vertetoje "produktin e dorezuar sot" AK deklaron se ka per detyre te sigurohet qe raporti i akredituar verteton saktesisht produktin e dorezuar ne proceduren aktuale dhe jo nje variant te kaluar. Kundershtimi: Ankuesi nuk mohon qe raporti laboratorik vlen per materialin e testuar dhe se rezultatet e laboratorit lidhen me mostren e testuar. Ceshtja eshte tjeter: Dosja e Tenderit i ka parapare si kerkesa te vecanta dorezimin e mostrave dhe dorezimin e atesteve laboratorike. Ne tekstin e Kerkeses 2/Deshmise 2 nuk eshte percaktuar qe mostra fizike e dorezuar ne tender duhet te jete pikerisht e njejta cope qe eshte testuar ne laborator. Ne rastin konkret, materiali i perdorur ne mostren e dorezuar ne proceduren aktuale eshte i njejti material, me te njejten perberje dhe karakteristika teknike, ndersa ndryshimet e bera kane qene vetem ne elementet vizuale te produktit. Nese AK e konsideron si kusht eliminues qe mostra tenderuese te jete pikerisht e njejta cope fizike qe i eshte nenshtruar testimit laboratorik, nje kusht i tille duhet te kishte qene i percaktuar paraprakisht ne

dokumentacionin e tenderit. 5. Konstatimi i AK-se se raporti nuk garanton qe mostrat e tanishme jane testuar AK perfundon se raporti i dorezuar nuk garanton qe mostrat e tanishme i jane nenshtruar testimit dhe, per kete arsye, konsideron se OE nuk ka deshmuar plotesisht perputhshmerine. Kundershtimi: PROFI LAB konfirmon se gjate testimit mostrat tekstile, varesisht nga metodat dhe standardet, priten, cmontohen, lahen, u nenshtrohen testimeve fizike dhe mekanike dhe ndryshohen ne menyre te perhershme. Si rrjedhoje, mostrat e testuara nuk jane te pershtatshme per perdorim ose dorezim te mevonshem si mostra tenderuese. Edhe Neni 37.6 i Rregullores per Prokurimin Publik e njeh shprehimisht mundesine qe testi teknik ta shkaterroje mostren, duke parapare kthimin e mostrave te tenderuesve jo te suksesshem vetem nese ato ende ekzistojne fizikisht. Kjo e perforcon dallimin ndermjet funksionit te mostres tenderuese dhe funksionit te testimit laboratorik. Mostra fizike e dorezuar ne tender nuk ka pse te jete e njejta cope fizike e konsumuar apo ndryshuar gjate testimit laboratorik. Relevante eshte qe materiali i perdorur te jete i njejte dhe te kete te njejtat karakteristika teknike te deshmuara me atestet laboratorike. Megjithate, ankuesi nuk kerkon qe OSHP te supozoje automatikisht identitet teknik; kerkon qe te zbatohet kerkesa reale e Dosjes dhe te vleresohen sqarimet e laboratorit mbi faktet teknike. AK ka kerkuar ateste per materialet baze dhe ne asnje pjese te Dosjes se Tenderit nuk ka kerkuar ateste per produktin final. Per rrjedhoje, eliminimi i ofertes sone mbi nje kerkese te tille te paspecifikuar eshte ne kundershtim me kriteret e percaktuara ne Dosjen e Tenderit. MOSKERKIMI I SQARIMIT PARA VENDIMIT Rregullorja per Prokurimin Publik, Neni 38, parashikon mekanizmin e sqarimit te tendereve. Neni 38.1 lejon kerkesen individuale per sqarim, ndersa Neni 38.4 parashikon kerkimin e informacionit me qellim te qartesimit te permbajtjes se deklaratave te paqarta dhe certifikatave te perfshira ne tender. Ne rastin konkret, AK nuk ka kerkuar nga FWRDZ L.L.C. sqarim lidhur me daten, lidhjen teknike te raporteve me materialin, natyren e ndryshimeve vizuale ose metoden e shenuar ne raport. Kjo eshte vecanerisht relevante sepse sqarimet e marra me pas nga vete laboratori adresojne drejtperdrejt keto ceshtje pa ndryshuar cmimin, produktin e ofertuar ose ndonje kusht material te tenderit. Keto deklarata nuk paraqiten si zevendesim i nje dokumenti qe ka munguar ne oferte, por si sqarim nga leshuesi i dokumenteve ekzistuese per permbajtjen dhe kuptimin teknik te tyre. NENI 40.2 DHE 40.12 I RREGULLORES - PIKA KRYESORE JURIDIKE Neni 40.2 i Rregullores per Prokurimin Publik kerkon qe tenderet te ekzaminohen, vleresohen dhe krahasohen ne perputhje me procedurat dhe kriteret e percaktuara ne Njoftimin per Kontrate/Dosjen e Tenderit dhe ndalon shtimin e kerkesave, kritereve ose specifikimeve te reja gjate vleresimit. Neni 40.12 percakton se tenderuesi nuk do te diskualifikohet ose perjashtohet nga procedura ne baze te nje kerkese apo kriteri qe nuk eshte specifikuar ne Njoftimin per Kontrate/Dosjen e Tenderit. Ne rastin konkret, Dosja kerkon ateste te kryera nga laborator i akredituar sipas specifikimeve teknike per artikujt nr. 4 dhe 8. Nese AK e kushtezon pranueshmerine me nje raport te ri, me testim te kryer posacerisht per kete numer te ritenderit ose me kushtin qe mostra tenderuese te jete pikerisht e njejta cope fizike e testuar ne laborator, duhet te tregoje se ku eshte percaktuar ky kusht ne Dosjen e Tenderit. DEKLARATA ZYRTARE E PROFI LAB MBI DATEN DHE NDRYSHIMET VIZUALE PROFI LAB ka konfirmuar se data e leshimit te raportit laboratorik, ne vetvete, nuk perben deshmi teknike se karakteristikat teknike te testuara kane ndryshuar dhe se nje percaktim mbi karakteristikat teknike mund te behet vetem permes ekzaminimit laboratorik sipas standardeve perkatese. Ky sqarim lidhet drejtperdrejt me arsyetimin e AK-se: data e raportit mund te jete fakt relevant, por nuk provon vetvetiu se materiali ose parametrat teknike te produktit kane ndryshuar. SQARIMI SHTESE PER RAPORTIN T102557-2 PROFI LAB ka leshuar edhe nje deklarate te posacme lidhur me raportin T102557-2. Laboratori konfirmon se shenimi i metodes ISO 3801 Part III per masen siperfaqesore ka qene rezultat i nje gabimi administrativ dhe se gjate testimit eshte perdorur metoda EN ISO 12127:2014. Laboratori

sqaron se, sipas vleresimit te tij teknik, standardet e permendura nuk kane dallime ne metodologji, dallime teknike ose ne procedurat e testimit dhe se rezultatet e fituara jane te njejta. Ky dokument paraqitet si sqarim i leshuesit te raportit per nje raport ekzistues dhe jo si ndryshim i ofertes. 9. Dëmet materiale Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim. Anulimi i aktivitetit të prokurimit dhe mosvlerësimi i drejtë i ofertës së FWRDZ L.L.C. i shkakton dhe rrezikon t'i shkaktojë Operatorit Ekonomik dëm material, përfshirë shpenzimet e bëra për përgatitjen dhe pjesëmarrjen në procedurën e prokurimit, sigurimin e mostrave, testimet laboratorike, dokumentacionin dhe shpenzimet e tjera të lidhura me ofertimin. Gjithashtu, si pasojë e vendimit të kontestuar, FWRDZ L.L.C. humb mundësinë për vlerësim të ligjshëm të ofertës dhe për fitimin e kontratës. Për këtë arsye kërkohet anulimi i vendimit të kontestuar dhe kthimi i aktivitetit të prokurimit në rivlerësim.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Pretendimi i OE-së ankuese që është eliminuar padrejtësisht nuk qëndron. Autoriteti Kontraktues ka vepruar në harmoni të plotë me LPP

Autoriteti Kontraktues (AK) e hedh poshtë si të pabazuar ankesën e Operatorit Ekonomik (OE) FWRDZ L.L.C., Gjilan, me pikat e sqaruara si më poshtë:

Pretendimi i OE-së se raporti laboratorik i referohet të njëjtit produkt me 100% të njëjtat materiale është i paqëndrueshëm. Vetë OE në ankesën e tij pranon se mostra e dorëzuar në procedurën e kaluar ka pasur dështime në "elemente vizuale, përkatësisht yllin dhe vijën e gradës Kadett". Rrjedhimisht, mostra e dorëzuar në këtë procedurë të re përfaqëson një produkt të modifikuar ose të prodhuar rishtazi për të përmbushur ato mangësi vizuale. Një raport laboratorik i lëshuar për një mostër që ka dështuar (pavarësisht nëse dështimi ka qenë vizual apo strukturor) nuk mund të certifikojë një mostër të re të modifikuar.

OE pretendon se raportet laboratorike nuk kanë qenë objekt kontestimi vitin e kaluar. AK sqaron se në procedurën e kaluar, vlerësimi ka ndaluar në momentin që është konstatuar mospërputhja e mostrës fizike me kriteret e DT-së. Fakti që AK nuk ka vazhduar me kontestime të tjera teknike vitin e kaluar, nuk nënkupton "aprovim në heshtje" të raportit laboratorik për procedurat e ardhshme, e aq më pak për mostra të cilat kanë pësuar ndryshime fizike/vizuale për tu përshtatur.

Parimi i Sigurisë Teknike dhe Integritetit të Ofertës (Neni 59 i LPP-së): Ndonëse DT nuk specifikon një datë skadence, qëllimi i raporteve laboratorike është të garantojnë përputhshmërinë e produktit që ofrohet aktualisht. Paraqitja e një raporti laboratorik që është përdorur për një mostër që ka dështuar në të kaluarën, cenon parimin e sigurisë teknike. OE është eliminuar në një aktivitet të mëhershëm (vitin 2025), respektivisht është refuzuar më datë 11.11.2025 në aktivitetin:

"FURNIZIM ME SPALETA PËR PK-në RITENDER 1" Nr. i prokurimit: 214/30400-25-9288-1-2-1 & 214-25-034-1-2-1

për arsye të dëshmisë të dimensioneve me po të njëjtin atest me numër T102557-2, të cilin e ka prezantuar edhe në aktivitetin në fjalë.

AK ka për detyrë të sigurohet që raporti i akredituar vërteton saktësisht produktin e dorëzuar sot, dhe jo një variant të kaluar që nuk ka kaluar vlerësimin.

Meqenëse raporti laboratorik i dorëzuar nuk garanton se mostrat e tanishme i janë nënshtruar këtij testimi, AK konsideron se OE ka dështuar të dëshmojë plotësisht përputhshmërinë teknike të produktit sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit. Vendimi për eliminim mbetet në fuqi.

Gjithashtu vlen të ceket edhe një vërejtje, por të cilën nuk e kemi potencuar, pasi që AK nuk e ka konsideruar Atestin.

Raporti me numër T102557-2 nga laboratori i kryer atestet, ka bërë atest të një parametri edhe pse nuk ka qenë i certifikuar nga trupi akreditues si në vijim: ISO 3801 Part III. Andaj OE është i papërgjegjshëm dhe ankesa i refuzohet.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 17.08.2026. ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2026/0598, ndërsa me datë 31.08.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0598, me rekomandimet si në vijim:Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është përgjigjur rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa

OE është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e “FWRDZ L.L.C.”eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0598 ka vlerësuar si në vijim:

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues i pakënaqur me njoftimin mbi Vendimin (B58) për anulimin e aktivitetit të prokurimit, të AK – Policia e Kosoves, ka parashtruar ankese ne OSHP me pretendimin se autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar dispozitat e nenit 59 të LPP-së.

Pas perfundimit të vleresimit të ofertave AK-Policia e Kosoves, e njofton OE ankues me letren standarde të tenderuesit te eliminuar, të cilin e eliminon me arsyetimin si më poshtë:

Sa i perket arsyes se eliminimit, lidhur me daten e raportit të atesteve 28.10.2025, eksperti shqyrtues vlereson se nuk qendron ky arsyetim i autoritetit kontraktues, sepse autoriteti kontraktues konform dispozitave të nenit 72 dhe 59 të LPP-së, mund të kërkojë sqarime shtese nga lobaratori përkatës dhe për cdo dyshim tjeter mund të kërkojë nga operatori ekonomik ateste

të reja.

Sa i përket mosplotesimit të specifikave teknike, përgjigjjet ne pretendimet ankimore teknike i ka dhene ekseprti teknike:

1. Baza e autorizimit dhe objekti i ekspertizës

Me autorizimin e OSHP-së, Ref. 2026/0598, datë 18.08.2026, unë, Gentiana Miftari, jam caktuar eksperte teknike, në bashkëpunim me eksperten shqyrtuese Florije Rexhepi, për shqyrtimin e ankesës së Operatorit Ekonomik FWRDZ L.L.C. lidhur me aktivitetin e prokurimit "FURNIZIM ME SPALETA RITENDER", nr. 214/30400-26-4777-1-2-1, të iniciuar nga Policia e Kosovës.

Në këtë raport kam shqyrtuar aspektet teknike të dokumentacionit relevant, kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe Aneksit 1, raportet/atestet laboratorike të dorëzuara për artikujt nr. 4 dhe 8, si dhe konstatimet e mia nga ekzaminimi fizik i mostrave të FWRDZ L.L.C. Raporti im kufizohet në aspektet teknike; çështjet juridike të ngritura në ankesë i paraqes vetëm në masën e nevojshme për të kuptuar pretendimet.

2. Dokumentacioni i shqyrtuar

·Autorizimi i OSHP-së Ref. 2026/0598, datë 18.08.2026;

·Ankesa e FWRDZ L.L.C., datë 13.08.2026, dhe dokumentet përcjellëse;

· Dosja e Tenderit / Njoftimi për Kontratë dhe Aneksi 1 – Specifikacionet Teknike të Detyrueshme;

·Oferta dhe deklaratat e FWRDZ L.L.C., përfshirë deklaratën e prodhuesit dhe deklaratën për përmbushjen e specifikimeve teknike;

·Raportet laboratorike të PROFI LAB për artikullin nr. 4 – Grada Polic i Lartë dhe artikullin nr. 8 – Grada Major, të lëshuara më 28.10.2025;

· Lista/fushëveprimi i akreditimit të laboratorit PROFI LAB;

· Dokumentet e Autoritetit Kontraktues lidhur me vlerësimin/eliminimin dhe anulimin e aktivitetit;

·Mostrat fizike të FWRDZ L.L.C. të ekzaminuara në Policinë e Kosovës më 24.08.2026 dhe fotografitë e realizuara gjatë ekzaminimit.

3. Kërkesat teknike relevante të Dosjes së Tenderit

Te kapaciteti teknik dhe profesional, Dosja e Tenderit kërkon që OE të dorëzojë nga një palë (2 copë) mostra për secilin artikull nga pozicioni 1 deri 13 sipas Aneksit 1. Veçmas, Kërkesa 2 kërkon ateste të kryera për artikujt nr. 4 dhe 8 nga një laborator i akreditуar sipas specifikimeve teknike të Aneksit 1. Për artikujt nr. 2, 3 dhe 4 kërkohen gjithashtu mostra me numra identifikues pesëshifrorë.

Aneksi 1 përcakton se materialet themelore, ngjyrat dhe materialet me të cilat punohen/qëndisen spaletat duhet të dëshmohen me atestet laboratorike përkatëse. Për materialin themelor janë përcaktuar, ndër të tjera, përbërja PES 55% / WO 45%, ngjyra 19-3934, masa 200 g/m² (±5%), diametri i fibrës së leshit 21.5 µm, dendësia e fijeve, forca e thyerjes, rezistenca ndaj cuklave dhe pastrimit, stabiliteti dimensional dhe qëndrueshmëria e ngjyrës.

Për Gradën Major, Aneksi 1 përshkruan spaletë me ngjyrë të kaltër të mbyllur, shirit rrethues ngjyrë ari dhe një yll gjashtëcepësh të mbushur; dimensionet e përcaktuara përfshijnë gjatësinë qendrore 140 mm, gjatësinë jashtë thyerjes 110 mm, thyerjen 40 mm, gjerësinë 60/55 mm dhe yllin 17 mm. Për variantin solemn parashihet shirit rrethues 8 mm, ndërsa për variantin standard 4 mm.

4. Pretendimi teknik i ankuesit dhe çështja kontestuese

FWRDZ L.L.C. kundërshton vendimin e AK-së dhe, në aspektin teknik, argumenton se Dosja e Tenderit i trajton si kërkesa të ndara mostrat fizike dhe atestet laboratorike. Ankuesi pretendon se DT nuk ka përcaktuar datë skadence të atesteve, nuk ka kërkuar që raportet të lëshohen posaçërisht për ritenderin dhe nuk ka kërkuar që mostra fizike e dorëzuar në ritender të jetë e njëjta copë fizike mbi të cilën është kryer testimi laboratorik.

Ankuesi pretendon gjithashtu se materiali i përdorur në procedurën aktuale është i njëjtë me materialin e testuar dhe se ndryshimet kanë qenë vetëm në elemente vizuale. Në ankesë referohet edhe një sqarim i PROFI LAB lidhur me materialin dhe metodën e testimit. Këto i trajtoj në kuadër të dokumentacionit të paraqitur nga ankuesi. Nga ekzaminimi fizik që kam kryer më 24.08.2026 nuk kam pasur mundësi të verifikoj në mënyrë të pavarur identitetin teknik të materialit të vitit 2026 me materialin e testuar në vitin 2025, pasi mostrat e vitit 2025 nuk kanë qenë në dispozicion.

5. Shqyrtimi i raporteve laboratorike

Raporti laboratorik për Gradën Major raporton, ndër të tjera: përbërje PES 55% / WO 45%; masë 200 g/m²; diametër të fibrës së leshit 21.5 µm; WARP 35/cm dhe WEFT 19/cm; forcë thyerjeje WARP 110 daN dhe WEFT 55 daN; pilling 5 pas 18,000 dhe 36,000 cikleve; rezistencë në abrazion 25,000 cikle; stabilitet dimensional -1.5% / -1.5%; dhe vlera 5 për testet e qëndrueshmërisë së ngjyrës. Raporti për Gradën Polic i Lartë paraqet parametra të ngjashëm dhe përfundon se mostrat e testuara plotësojnë kërkesat teknike të referuara në raport.

Gjatë krahasimit dokumentar kam vërejtur se Aneksi 1 kërkon për masën standardin ISO 3801 Part III, ndërsa raporti për Gradën Major e paraqet ISO 12127. Për raportin e Gradës Polic i Lartë është paraqitur ISO 3801 Part III; në ankesë është paraqitur sqarimi se PROFI LAB e ka cilësuar këtë shënim si gabim administrativ dhe se gjatë testimit është përdorur EN ISO 12127:2014. Po ashtu, Aneksi 1 përmend BS 5811 për cuklat dhe BS 5690 për rezistencën në pastrim, ndërsa raportet përdorin EN ISO 12945-2 dhe EN ISO 12947-2. Në dokumentacionin e akreditimit të laboratorit gjenden metoda EN ISO 12945-2 dhe EN ISO 12947-2. Për qëllim të këtij raporti nuk i barazoj automatikisht standardet me emërtim të ndryshëm; nëse kjo çështje konsiderohet vendimtare, ekuivalenca duhet të mbështetet me sqarim teknik të dokumentuar nga

laboratori ose organi kompetent.

Gjithashtu, në tabelat e rezultateve të raporteve që kam shqyrtuar nuk kam evidentuar veçmas parametrin "Relaksimi në tkurrje SHIRLEY WARP/WEFT min. 155°", i cili figuron në Aneksin 1. Për këtë arsye, vetëm nga këto tabela nuk mund të konkludoj se ky parametër specifik është dëshmuar.

6. Ekzaminimi fizik i mostrave – 24.08.2026

Më 24.08.2026, unë, Gentiana Miftari, në rolin e ekspertes teknike, së bashku me eksperten shqyrtuese Florije Rexhepi, kam bërë ekzaminimin fizik të mostrave të FWRDZ L.L.C. në Policinë e Kosovës. Mostrat e vitit 2025 nuk kanë qenë në dispozicion për krahasim me mostrat e ritenderit.

Gjatë së njëjtës vizitë kam parë edhe mostrat e disa operatorëve të tjerë ekonomikë, vetëm me qëllim të krijimit të një reference krahasuese vizuale ndërmjet punimit të mostrave. Këto mostra nuk kanë qenë objekt i ekspertizës sime dhe nuk i kam përdorur si bazë për vlerësimin e përputhshmërisë së ofertës së FWRDZ L.L.C. me Dosjen e Tenderit. Vlerësimi dhe konstatimet e këtij raporti lidhur me mostrat fizike i referohen mostrave të FWRDZ L.L.C.

Gjatë ekzaminimit kam bërë vëzhgim vizual dhe matje orientuese të mostrave me metër tekstili, duke i krahasuar dimensionet e dukshme me kërkesat përkatëse të Aneksit 1. Matjet nuk janë regjistruar si seri e plotë e vlerave numerike për secilën mostër, prandaj në këtë raport nuk paraqes rezultate dimensionale të detajuara. Në punimin/qëndisjen e pjesës së artë kam vërejtur devijime të vogla në precizitet dhe simetri. Këtë e konsideroj vërejtje vizuale të punimit dhe, në mungesë të një tolerance të shprehur specifike për këtë element dhe të një evidentimi numerik të plotë të matjeve, nuk e trajtoj si provë të mjaftueshme për mospërputhje teknike apo si bazë të pavarur për eliminim.

Nuk kam kryer testime laboratorike të materialit dhe nuk kam pasur mundësi të bëj krahasim fizik me mostrat e FWRDZ L.L.C. të vitit 2025. Në mostrat që kam ekzaminuar nuk kam evidentuar kod materiali, numër loti apo identifikues tjetër që të mundësonte një verifikim të drejtpërdrejtë të lidhjes me raportet laboratorike të datës 28.10.2025. Theksoj se një identifikues i tillë nuk është evidentuar nga unë si kërkesë e shprehur e DT-së; ky fakt paraqitet vetëm si kufizim i mundësisë sime për verifikim të pavarur. Për rrjedhojë, vetëm nga ekzaminimi vizual dhe matjet orientuese me metër tekstili nuk mund të vërtetoj dhe as të përjashtoj se materiali aktual është identik me materialin e testuar në vitin 2025.

7. Analiza teknike

7.1. Atesti i vitit 2025 dhe kërkesa për ritestim

Nga formulimi i Kërkesës 2/Dëshmisë 2 në DT nuk kam identifikuar një kërkesë të shprehur që atesti të jetë lëshuar pas publikimit të ritenderit, të ketë afat të caktuar skadence, të mbajë numrin e aktivitetit aktual ose që mostra tenderuese të jetë pikërisht e njëjta copë fizike e testuar në laborator. Aneksi 1 e lidh kërkesën për ateste me materialet themelore, ngjyrat dhe materialet e

punimit/qëndisjes. Prandaj, nga këndvështrimi im teknik, data 28.10.2025 e raportit nuk provon vetvetiu se karakteristikat e materialit të raportuara nga laboratori kanë ndryshuar.

Megjithatë, vetëm nga inspektimi fizik që kam kryer nuk mund të konfirmoj në mënyrë të pavarur se materiali i mostrave të vitit 2026 është i njëjtë me materialin e testuar në vitin 2025. Kjo është një kufizim i verifikimit tim teknik dhe jo konstatim se materiali është i ndryshëm apo se DT ka kërkuar domosdoshmërisht identifikues loti/gjurmueshmërie.

7.2. Përputhja e metodave dhe parametrave të testimit

Raportet laboratorike përmbajnë një numër të konsiderueshëm parametrash që numerikisht përputhen ose tejkalojnë vlerat e kërkuara në Aneksin 1. Megjithatë, për disa parametra emërtimi i metodës së testimit ndryshon nga standardi i shkruar në Aneksin 1. Pa një dëshmi të qartë të ekuivalencës së metodave, nuk mund t'i barazoj automatikisht standardet e ndryshme vetëm mbi bazën e rezultateve numerike.

7.3. Konstatimet vizuale

Devijimet e vogla që kam vërejtur në precizitetin/simetrinë e pjesës së artë i evidentoj si vërejtje vizuale. Nga dokumentacioni që kam shqyrtuar, matjet orientuese të kryera dhe ekzaminimi fizik, nuk kam siguruar bazë të mjaftueshme për t'i klasifikuar këto devijime si mospërputhje materiale me specifikimin teknik.

8. Përfundimi teknik

Në bazë të dokumentacionit që kam shqyrtuar dhe ekzaminimit fizik që kam kryer më 24.08.2026, vlerësoj se arsyeja që një atest laboratorik është lëshuar më 28.10.2025, në vetvete, nuk është e mjaftueshme teknikisht për të konkluduar se materiali i ofruar në ritender nuk i plotëson karakteristikat e dëshmuara në atë raport. Dosja e Tenderit kërkon ateste për artikujt nr. 4 dhe 8 nga laborator i akreditуar sipas Aneksit 1, por në tekstin e kërkesës që kam shqyrtuar nuk kam identifikuar kusht të shprehur për datën e lëshimit, ritestimin për çdo procedurë të re apo identitetin fizik të mostrës tenderuese me mostrën e konsumuar/testuar në laborator.

Në të njëjtën kohë, nga ekzaminimi fizik që kam kryer nuk mund të konfirmoj në mënyrë të pavarur se materiali i mostrave të dorëzuara në vitin 2026 është identik me materialin e testuar në vitin 2025. Mostrat e vitit 2025 nuk ishin në dispozicion. Për këtë arsye, vetëm inspektimi vizual dhe matjet orientuese nuk janë të mjaftueshme për të provuar apo përjashtuar identitetin e materialit. Ky kufizim nuk duhet interpretuar si konstatim i mospërputhjes së materialit.

Po ashtu, kam evidentuar dallime ndërmjet disa metodave të emërtuara në Aneksin 1 dhe metodave të shënuara në raportet laboratorike, si dhe mungesë të evidentimit të veçantë të parametrit "Relaksimi në tkurrje SHIRLEY" në tabelat e rezultateve që kam shqyrtuar. Këto çështje i konsideroj të ndara nga çështja e datës së atestit dhe, nëse janë vendimtare për vlerësimin e përgjegjshmërisë së tenderit, vlerësoj se kërkojnë sqarim teknik të dokumentuar nga laboratori/organ kompetent mbi metodën, ekuivalencën dhe gjurmueshmërinë e materialit.**9. Mendimi i ekspertit teknik**

Në aspektin strikt teknik, vlerësoj se pretendimi i ankuesit është i bazuar në pjesën ku kundërshton papranueshmërinë e atesteve vetëm për shkak të datës së tyre ose për shkak se mostra aktuale nuk është e njëjta copë fizike e testuar, pasi në kërkesën teknike të DT-së që kam shqyrtuar nuk kam identifikuar një kusht të tillë të shprehur. Njëkohësisht, nga inspektimi im fizik nuk mund të jap konfirmim të pavarur laboratorik për identitetin e materialit 2025–2026. Dallimet në emërtimin e disa metodave të testimit dhe parametri SHIRLEY i evidentuar më sipër duhet të trajtohen si çështje teknike të veçanta dhe jo të përdoren si zëvendësim i arsyes së dhënë për refuzimin vetëm mbi bazën e datës së atestit.

Për rrjedhojë, rekomandoj që në vlerësimin e mëtejmë të bëhet dallim ndërmjet: (i) pranueshmërisë së atestit në raport me kërkesën e shkruar të DT-së dhe mungesës së një kushti të shprehur për datën/ritestimin; (ii) asaj që mund të verifikohet nga inspektimi fizik i mostrës; dhe (iii) përputhjes së metodave/parametrave laboratorikë me Aneksin 1. Nga këndvështrimi im teknik, këto janë çështje të dallueshme dhe duhet të vlerësohen mbi bazën e dokumenteve dhe kërkesave përkatëse.

10. Kufizimet e ekspertizës

-Nuk kam kryer testime të reja laboratorike;

·Gjatë vizitës së 24.08.2026 kam kryer matje orientuese me metër tekstili, por nuk kam regjistruar një seri të plotë të vlerave numerike për secilën mostër dhe matjet nuk janë kryer me instrument laboratorik të kalibruar;

·Nuk kam pasur në dispozicion mostrat e FWRDZ L.L.C. nga procedura e vitit 2025 për krahasim;

·Nuk kam evidentuar kod/lot/identifikues në mostrat aktuale që të mundësonte verifikim të drejtpërdrejtë me raportet T102557-1/T102557-2; këtë e paraqes si kufizim të verifikimit tim dhe jo si kërkesë shtesë të DT-së;

·Për vlerësimin e ekuivalencës normative ndërmjet standardeve të ndryshme të testimit mbështetem në nevojën për dëshmi/sqarim nga organ kompetent ose laborator i akreditуar.

MENDIMI PËRFUNDIMTAR DHE REKOMANDIMI

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të lëndës, pretendimeve ankimore, kërkesave të Dosjes së Tenderit dhe Aneksit 1, si dhe pas ekzaminimit fizik të mostrave, mendimi im përfundimtar në cilësinë e ekspertes teknike është që ankesa e Operatorit Ekonomik FWRDZ L.L.C. të aprovohet në pjesën e pretendimeve teknike të shqyrtuara dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Ky mendim mbështetet në faktin se nga kërkesat e shqyrtuara të Dosjes së Tenderit nuk rezulton të jetë përcaktuar shprehimisht që atestet laboratorike duhet të jenë të lëshuara pas inicimit të aktivitetit aktual të prokurimit, të kenë një afat të caktuar vlefshmërie apo që mostra fizike e dorëzuar në këtë procedurë duhet domosdoshmërisht të ritestohet. Për rrjedhojë, vetëm fakti që atestet laboratorike janë të datës 28.10.2025 nuk paraqet, nga aspekti teknik dhe bazuar në kërkesat e shqyrtuara të Dosjes së Tenderit, bazë të mjaftueshme për refuzimin e tyre.

Megjithatë, ky përfundim nuk nënkupton konstatim se materiali i mostrave të vitit 2026 është provuar laboratorikisht si identik me materialin e testuar në vitin 2025. Gjatë ekzaminimit fizik nuk kam pasur në dispozicion mostrat e vitit 2025 për një krahasim të tillë dhe kjo çështje nuk mund të vërtetohet vetëm përmes ekzaminimit vizual.

Prandaj, rekomandimi im përfundimtar është: APROVOHET ANKESA në pjesën e pretendimeve teknike të shqyrtuara dhe LËNDA KTHET NË RIVLERËSIM.

SHTOJCA 1 – DOKUMENTIM FOTOGRAFIK NGA EKZAMINIMI FIZIK

Fotografitë e mëposhtme janë realizuar gjatë ekzaminimit fizik të datës 24.08.2026 dhe paraqesin mostrat e FWRDZ L.L.C. të shqyrtuara në Policinë e Kosovës. Ato shërbejnë si dokumentim vizual plotësues i konstatimeve të përshkruara në raport

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit "FURNIZIM ME SPALETA RITENDER" me nr. të prokurimit: "214/30400-26-4777-1-2-1",

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtresat dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë, se ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar kjo duke u bazuar edhe në kërkesat qe vet ka përcaktuar AK-ja në Njoftimin për kontrate sipas kapacitetit teknik /dhe profesional citoj '' Operatori Ekonomik duhet të dorëzoj atestet të kryera për artikullin me numër 4 dhe 8 nga një Laborator i akredituar sipas specifikave teknike Aneksi 1. Dëshmi dokumentare 2 Dorëzimi i atesteve të kryera nga një Laborator i akredituar për artikullin me numër 4 dhe 8 sipas specifikave teknike te kërkuara, kështu duke mos kërkuar që atestet të jenë të kryera sipas titullit të kontratës , ndërsa vetë AK-ja tek procedurat tjera si shembull uniformat ku OE-të kanë ofruar atestet me vite shume me të hershme e që për AK-në kan qen te pranueshme, ndërsa në këtë procedur i konsideron si të vlefshme (atestet e ofruara nga viti 2025) , per çka Paneli Shqyrtues konstaton se AK në procedura është duke aplikuar standarde të dyfishta për çka dhe i shqipton vërejtje, dhe derisa ka pasur mundësi aplikimin e nenit 52.7 të LPP-se kështu duke kryer një kontroll efektive , si dhe ekzaminim e mostrave se a janë sipas specifikacioneve teknike te detyruara AK eliminon OE ankues nga kjo procedur Andaj, në ketë rast Paneli e mbështet raportin e ekspertizës nga ekspertet shqyrtues/ dhe teknik i cili është hartuar në mënyrë profesionale dhe i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së.

Si rrjedhojë, Paneli Shqyrtues bazuar në nenin 1 dhe 7 të LPP-se e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues / dhe teknik duke vendosur qe të anulohet B58Njoftimi mbi vendimin e AK-se '' lidhur me aktivietin me titull ''FURNIZIM ME SPALETA RITENDER'' , nr 214/30400-26-4777-1-2-1 dhe lënda të kthehet në ri-vlersim. Duke kërkuar nga AK-ja që gjatë rivlerismit të ofertave ti përmbahet në tersi kërkesave sipas NJK-se dhe DT-se (specifikacioneve teknike) identifikimin e mostrave të dorëzuara si dhe dispozitave tjera ligjore të LPP-se.

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nënpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji". Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahimi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me padi mund t'i drejtohet Gjykatës Administrative në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm për anulim të vendimit në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **POLICIA E KOSOVËS**
- OE - **FWRDZ L.L.C.**
- Arkivës së OSHP-së: